

VENDIM
Nr. 205, datë 10.4.2019

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA KATEGORIA E RESURISIT “TOKË BUJQËSORE” (ARË) NË “TOKË URBANE” (TRUALL), TË PASURISË ME NR. 1/27, ZONA KADASTRALE 3339, BASHKIA DURRËS, PËR NDËRTIMIN E NJË KAPANONI NJËKATËSH, FABRIKË PRODHIMI TË BOJËRAVE, NGA ANA E “ZEUS-AL” SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” (arë) në “tokë urbane” (truall), të pasurisë me nr. 1/27, zona kadastrale 3339, Bashkia Durrës, me sipërfaqe prej 4 870 (katërmijë e tetëqind e shtatëdhjetë) m², sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi, për ndërtimin e një kapanoni njëkatësh, fabrikë prodhimi të bojërave, nga ana e “ZEUS-AL” sh.p.k.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës të qarkut Durrës të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral përkatës ndryshimet e kategorisë së resursit, nga “tokë bujqësore” (arë) në “tokë urbane” (truall), për sipërfaqen prej 4 870 (katërmijë e tetëqind e shtatëdhjetë) m², sipas pikës 1, të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës të qarkut Durrës, Këshilli i Qarkut Durrës, Agjencia Shtetërore e Kadastrës (Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës) dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lidhja nr. 1

Tokë arë (kategoria V)

Bashkia	Njësia administrative	Fshati	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Pronari	Lloji i pasurisë	Kategoria e tokës bujqësore	Truall i kërkuar (m ²)
Durrës	Rrashbull	Vrrinë	3339	1/27	Shoqëria “ZEUS-AL” sh.p.k.	arë	V	4 870
TOTALI								4 870